

Koktej lamtumire për nder të Ambasadorit të Bashkimit Evropian në Republikën e Maqedonisë, z. Aivo Orav



Në hapësirat e Klubit të deputetëve u realizua koktej lamtumirës për nder të euro ambasadorit z. Aivo Orav, ku të ftuar ishin ambasador të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, ambasador të vendeve të rajonit si dhe ambasadori i SHBA-ve z. Jess L Baily.

[më shumë](#)

Zëvendëskryeministri Ademi mori pjesë në takimin e Kryeministrit Dimitriev me Ministrin e Punëve të Jashtme grek z Nikos Kotzias në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë

[më shumë](#)



Takim koordinues me donatorë lidhur me dëmet e pësura nga stuhia ne Shkup dhe Tetovë

Në hapësirat e Sekretariatit për Çështje Evropiane u realizua takim koordinues me donatorë, lidhur me vërshimet katastrofale që ndodhën fundjavën e kaluar. Zëvendëskryeministri i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë përgjegjës për Çështje Evropiane Dr. Arbër Ademi, ishte udhëheqës i takimit, ndërkaq fjalime mbajtën edhe z. Nikolla Todorov, Zëvendëskryeministër i Qeverisë dhe Ministër i Shëndetësisë, Ministri i financave, z. Kiril Minoski z. Ilija Isajloski, Zëvendës ministër për Punë të Jashtme, si dhe z-nja Luiza Vinton, koordinator i përhershëm i OKB-së dhe përfaqësuese e përhershme e UNDP-së si dhe Martin Klauke, Udhëheqës i sektorit për bashkëpunim në Delegacionin e BE-së në Shkup.



U potencua se në këtë fazë vlerësimet e dëmeve janë shumë indikative, por punohet në qartësimin e tyre. Ademi informoi se edhe është aktivizuar Mekanizmi për mbrojtje civile të BE-së, mes të cilave janë bërë xhirime satelitore të terrenit por në teren janë edhe ekspertët e tyre për vlerësimin e nevojave fillestare për popullsinë

[më shumë](#)

Takim i dytë koordinues me donatorë lidhur me dëmet e pësura nga stuhia ne Shkup dhe Tetovë

Në hapësirat e Sekretariatit për Çështje Evropiane u realizua takim koordinues me donatorë, i dyti me radhë lidhur me vërshimet katastrofale që ndodhën 06.08.2016. Zëvendëskryeministri i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë përgjegjës për Çështje Evropiane Dr. Arbër Ademi, ishte udhëheqës i takimit, ndërkaq fjalime mbajtën edhe z. Piter Hlieram udhëheqës i ekipit të ekspertëve që arritën në Republikën e Maqedonisë përmes Mekanizmi të Bashkimit Evropian për Mbrojtje Civile, si dhe z-nja Luiza Vinton, koordinator i përhershëm i OKB-së dhe përfaqësuese e përhershme e UNDP-së. Zëvendëskryeministri Ademi theksoi se qëllimi i takimit është të fitohet një pasqyrë më e qartë për mbështetjen e përgjithshme të donatorëve, për të cilën nga ky moment u sigurua nga ana partnerëve bilateral, për të cilën fillimisht u diskutua edhe në mbledhjen paraprake.



[më shumë](#)

Takime Pune



Takim i Zëvendëskryeministrit Ademi me Ambasadorin e mbretërisë së Spanjës Karanza

Zëvendëskryeministri i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë përgjegjës për Çështje Evropiane, Dr. Arbër Ademi, realizoi takim me Sh.T. Ramon Abaroa Karanza, ambasador i Mbretërisë së Spanjës në Republikën e Maqedonisë.

Në takim u diskutua gjendja aktuale në procesin euro-integrues të vendit, zhvillimi i ngjarjeve politike në këtë kontekst, dhe perspektivat deri në fund të vitit. Zëvendëskryeministri Ademi potencoi se përreth gjendjeve momentale, në fokus gjithashtu mbeten realizimi i plotë dhe konsekuent i Marrëveshjes së Shkupit dhe marrëveshja e fundit mes katër partive politike, implementimi i marrëveshjes kornizë të Ohrit dhe implementimi i mëtejshëm i Reformave Urgjente Prioritare.

[më shumë](#)



Takim i Zëvendëskryeministrit Ademi me ambasadorin e Francës Sh.S z-nja Lorens Oer

Zëvendëskryeministri i Qeverisë përgjegjës për Çështje Evropiane Dr. Arbër Ademi me 15.08.2016 realizoi takim përshëndetës me ambasadorin e Republikës së Francës në vendin tonë Sh.S z-nja Lorens Oer.

Në fillim të takimit Zëvendëskryeministri Ademi falënderoi z-nj Oer për mbështetjen e saj personale si dhe për mbështetjen dhe ndihmën e Republikës së Francës për vendin tonë dhe për përpjekjet e tyre për procesin euro-integrues, dhe në veçanti për mbështetjen e Sekretariatit për Çështje Evropiane dhe organet tjera shtetërore, Ambasadorja Oer theksoi se Franca do të vazhdojë të mbështesë procesin euro-integrues të Maqedonisë dhe theksoi se është e nevojshme thellimi i mëtutjeshëm i marrëdhënieve bilaterale mes dy vendeve. Në këtë kontekst, shprehu gatishmëri për sigurimin e mbështetjes së ekspertëve për menaxhimin me pasojat e vërshimeve që goditën kryeqytetin e Shkupit dhe pjesën veriperëndimore të Maqedonisë

[më shumë](#)

BE Lajme

- [Komisioni propozon vitin 2018 si vit Evropian i Trashëgimisë Kulturore](#)
- [Buxheti i BE-së për vitin 2017: Parlamenti përgatit qëndrimin e tij](#)
- [Statistikë Sociale më të mirë për Evropë Sociale](#)

A e dini...?

- [Në BE 74% e korrespondentëve kërkojnë që BE-ja të bëjë më shumë për migracionin, krahasuar me 74% në Irlandë dhe 68% në Mbretërinë e Bashkuar](#)
- [Lufta kundër mashtrimit tatimor u theksua nga ana e të anketuarve si prioritet i tretë më i rëndësishëm për BE-në](#)
- [Evropianët janë shumë të shqetësuar nga siguria kibernetike: 89% e të gjithë përdoruesve të internetit shmangin zbulimin e të dhënave personale në internet, ndërsa 85% pajtohen se rreziku për t'u bërë viktimë e krimit kompjuterik rritet](#)

Ditët ndërkombëtare

- [15 shtator Dita Ndërkombëtare e Demokracisë](#)
- [21 shtator Dita Ndërkombëtare e Paqes](#)
- [27 Shtator Dita Botërore e Turizmit](#)

Ju falënderojmë!